specifikuata në dosjen e tenderit. Kjo dispozitë duhet ndarë në tri pjesë të lidhura dhe të varura njëra me tjetrën, për të krijuar tërësinë e saj, ashtu siç e kërkon edhe profesionalizmi i zvrtarit përkatës që e zbaton.

l'aragrafi 4 e përcakton se në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, AK mund të kërkojë nga OE që të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve..,.
Nënparagrafi 5 i par.4 që krijon tërësinë e kësaj dispozite përcakton se në këtë kuptim AK mund apo duhet të kërkojë: *raportin ntbi nijetet, stabilitnentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realiziirtin c shërbiineve;*

Pra siç shihet me një interpretim të kësaj dispozite në mënyrë të thjeshtë, të logjikshme, duke mos e lexuar dhe kuptuar pjesë pjesë të ndara, por si tërësi,pa paragjykime dhe pa imagjinimin e situatave joreale por në suaza ligjore, rezulton se kërkesa e AK-së lidhur me afatin e regjistrimit është në tërësi në kundërshtim me vet Ligjin e Prokurimit Publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sipas ligjeve tjera në fuqi, janë të përcaktuara organet publike gjegjëse të autorizuara me ligj që kanë funksion, kompetencë dhe përgjegjësi që përkujdesen për zbatimin, marrjen e masave dhe mbikqvrjen e kësaj çështje.

E treta: Përkundër se kërkesa e AK-së sa i përkel regjistrimil të mjeteve nuk është kërkesë apo kriter i kërkuar sipas dispozitave të LPP-së (shih nenin 64 dhe nenin 69 par.4.5 të LPP-së) edhe vet arsyetimi i AK-së për këtë çështje është selektues dhe jo i plotë në kontekst lë gjendjes faktike. Me rastin e dt. së publikimit të këtij aktiviteti që është 21.03.2019, kamionit i tipit SCANIA me tabela 06-397-DL siç dëshmohet me librczë të regjistrimit ka qenë i regjistruar deri me dt. 12.04.2019 dhe regjistrimi i skaduar tri ditë para afatit sipas njoftimit për kontratë për dorëzim të tenderit dt.15.04.2019. Për më tepër sa për njohuri të AK-së për kamion është e obliguar dv herë mbrenda vitit t'i bëhet kontrollimi i rregullsisë teknike në perioda gjashtë (6) mujore. Andaj i njejti kamion e ka të kryer periodën e dytë të rregullsisë teknike deri me dt. 06.06.2019 dhe këtë e vërtetojmë përmes Çertifikatës periodike 06 03 P00957.

Dispozita e nenit 39 (Sqarimi i Tenderëve) i RrUOPP në paragrafin 3, përcakton qartë se autoritetit kontraktues se gjatë vlerësimit të tenderëve me qëllim të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve i lejohet që të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Për ta plotësuar tërësinë e kësaj dispozite me tutje përcaktohet se: "*Këto dokiinieiite, inegjithatë, ne ltiënyre objektive duliet të prezantojnë prova të nijaftitesliiie që në tnëmjrë të arsyeslinie pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikiinit te Njoftimit për kontrate.*

Pra në bazë të gjendjes faktike dhe interpretimit logjik dhe të thjeshtë të bazës ligjore sipas dispozitës së lartshënuar rezulton edhe një fakt më shumë se arsvetimi i AK-së i dhënc në pikën b) është në kundërshtim të plotë me këtë dispozilë nënligjore të RrUOPP. Siç e kemi potencuar edhe më lartë, gjendja ekzistuese faktike para publikimit për kontratë e OE ankues është në pajtim me këtë dispozitë ngase kamioni në fjalë ka pasur regjistrim para datës së publikimit për kontratë (dt. e publikimit 21.03.2019) dhe atë deri me dt. 12.04.2019, tri ditë para afatit për dorëim të tenderit sipas njoftimit për kontratë. Po ashtu ka edhe kontrollim të rregullsisë teknike deri me dt.06.06.2019 që vërteton gjendjen e rregullt teknike të mjetit për të marrë pjesë në trat'ik.

E katërta: Përkundër se regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që duhet të aplikohet në bazë të dispozitave të LPP-së, përkundër se kamioni në fjalë ka të kryer kontrollimin e rregullisë teknike periodike deri me dt. 06.06.2019 dhe me rastin e publikimit të njoflimit për kontratë deri tri ditë para datës së dorëzimit sipas NJK ishte i regjistruar, dhe pasqyrohet gjendja ekzistuesepara datës së publikimit të NJK në kuptim të nenil 39.3 të RrUOPP, kjo çështje në kuplim të interpretim.it logjik të nenit 59 par.-l pika ii), pa paragjvkim, dhe pa u keqinterpretuar për imagjinim të situatave joreale, përbën devijim të vogël që mund të rregullohet nga OE pa e

ndryshuar kushtin matcrial kundrcjt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë.

E pesta: Autoriteti Kontraktues me veprimet e saj duke mos vepruar konform dispozitave të LPP dhe duke mos iu shmangur favorizimit të OE të caktuar (në rastin konkret OE fitues) nuk është siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin, lëndën e prokurimit dhe duke u siguruar që do të mere vlerën për paranë (Best value for manv). Dhe si rrjedhojë duke mos iu përmbajtur procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji, e ka peshuar barabarsisht një devijim të vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e lenderit në 1'jalë me një shpenzim më të lartë të parave publike për 250,712.70C me të shtrejtë se sa oferta e ankuesit. Se nuk është siguruar vlera për para dhe mënvra më efikasë e shfrytëzimit të fondeve publike më së miri e pasqyron shembulli konkret që do ta ilustrojmë në vijim. OE fitues në Lot 1 ka ofertuar me çmim 3,250,795.50 rretli një milion euro më lirë se sa fituesi OE Eamis Co-Hc që ka ofertuar me çinim 4,276,744.89 dhe nuk është rekomanuar për kontratë, e në anën tjetër oferta e tij për lot 2 ishte 3,500,654.70€ rreth 250,712.70 më e shtrejtë se sa e ankuesit dhe është shpallur fitues.

Pra faktet dhe provat të cilat u pasqvruan në mënyrë të argumentuar dhe detajuar vërtetojnë se grupi i OE ankues ka plotësuar në tërësi kërkesat e AK-së të parashtruar në nenin 9.2 pika 5 Anexi 1 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së, dhe në tërësi duke plotësuar kriteret/kërkesat e përzgjedhjes të dosjes së tenderit dhe kriterin e dhënies si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, mirëpo si pasojë e mos trajtimit të barabartë/diskriminimit në raport me OE fitues dhe shkeljes së qëllimit të LPP-së duke mos siguruar vlera për para në shfrytëzimin e fondeve publike, iu është cenuar e drejta ligjore për tu shpërblyer me kontratë.

Andaj nga kjo gjendje faktike e pasqyruar si më lartë duke u bazuar me fakte dhe prova materiale vërtetohet se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 lidhur me nenin 69 par.4.5 dhe nenin 72 të LPP, ngase arsyetimi i saj nuk është i qëndrueshëm për shkak se OE ankues ka plotësuar në tërësi kërkesat teknike nga pika 5 të nenit 9.1&9.2 Anexi I siq janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe siq kërkohen me aktin më të lartë në fushën e prokurimit, Ligjit të Prokurimit Publik 04/L-042 në nenin 69 par.4.5, dispozitë e cila nuk është zbatuar drejt. Pretendimi Ankimor 3 lidhur me dhënien e kontratës për Lot 2 OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban"

Bazuar në dëshmitë që i kemi vërejtur gjatë qasjes zyrtare në dosjen e dorëzuar nga OE fitues, koniderojmë se i njejti nuk ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) tëspecifikuara në njoftim të kontratës dhe në dosjen e tenderit, përlatësisht kërkesat e kapacitetit teknik të kërkuara në pikën 5 të nenit 9.1 &9.2 sipas iistës së Anexit 1. 1 njejti me të njejta mjete ka aplikuar në të dy lotet. Dhe për më lepër për ta plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik ka përdorur dokumente edhe për mjetet e OE "Eskavatori" përkundër se e njejta ka marrë vet pjesë në këtë aktivitet prokurimi për dv lotet. Andaj AK është dashur që ta refuzojë si tender të papërgjegjshëm dhe mos të kalojë fare në krilerin për dhënien e kontratës sipas kritereve të vendosura në nenin 60 të LPP-së.

I'o ashtu ngrisim si pretendim qëshjen se AK tne rastin e dhënies së kontratës OE në fjalë përveq se ka shkelur qenësisht nenin 59.4 dhe nenin 69 par.4.5 të LPP-së, e ka shkelur dv herë nenin f dhe nenin 6 të LPP-së ngase po të ishte i përgjegjshëm OE në fjalë oferta e tij ishte shumë më e lirë në lot 1 me çmim 3,250,000.00€ ku ëshlë shpallur fitues oferta më e shtrejtë me çmim për 4,276,744.89€ (OE Famis Co-Hc).

Pretendimi Ankimor Nr.4 - lidhur me shkeljet veç e veç dhe të ndërlidhura të dispozitave nga neni 1, neni 6, neni 7, neni 59 par.2 dhe par.4, neni 69 par.4.5 dhe neni 72 të LPP-së, lidhur me nenin 4.4, nenin 39 dhe nenin 41.3 dhe 41.7 i KrUOPP

Nga krejt ajo që u Lha më lartë rrjedh se OE ankues për llot 2 ka dorëzuar tenderin e përgjegjshmë me çmim

më të ulët krahasuar nre OE të shpallur fitues për 250,712.70€ më të lirë ndërsa AK me veprimet e saj të paligjshme dhe diskriminuese ia ka cenuar ankuesit të drejtën për tu shpërblyer me kontratë duke i shkaktuar dëm material, dhe në anën tjetër ka favorizuar OE fitues duke e rekomanduar për dhënie përkundër faktit se i njejti ka dorëzuar tennder të papërgjegjshëm dhe që nuk plotëson kriterin e dhënies së kontratës. Andaj me këto veprime AK ka shkelur dispozitat qenësore dhe procedurale legjislacionit të prokurimit në fuqi duke filluar nga:

Neni 1 - Qëllimi dhe Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënvrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

AK duke shkelur këto dy dispozita qc përbëjnë edhe parimet bazike të prokuriinit publik përzgjedhë ofertën e tenderuesit të papërgjegjshëm e cila është rreth 250,712.70C më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çinim më të lirë e OE Ankues "EI-Bau-Conex Group".

Autoriteti Kontraktues, është i obliguar që të sigurohel që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënvrën rnë ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin, lëndën e prokurimit dhe duke u siguruar që do të mere vlerën për paranë (Best value for many).

Neni 7 - <u>Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi -</u>
Për arsye se rne qëllim të favorizimit të OE tjerë të përzgjedhur me çmim më të shtrejtë për 250,712.70€, AK e eliminon OE ankues, mbi bazën e vërtetimit të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike sa i përket arsyetimit të dhënë nc pikën a) dhe sa i përketarsvetimit të dhënë në pikën b) mbi bazën e një kriteri të natyrës teknike apo dvtësore që askund me asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet në bazë të legjislacionit të prokurimit publik dhe që në bazë të zbalimit të nenin 59.4 të LPP-së mund të klasifikohet si devijim i vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndrvshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë.

Autoriteti kontraktues duhet ti trajtoj operatorët ekonomik në mënvrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë ië gjitha masate nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial gjeografik, dikriminim material, ndërmjet operatorëve ekonomik.

Konsiderojmë se eliminimi nga pjesëmarrja e mëtutjeshme për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë vetëm me shkak të trajlimit jo të barabartë/diskriminimit në raport me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Po të trajtoheshim në bazë të kritereve të kërkuara ligjore do të ekzistonin gjasat serioze që të shpalleshim fitues për Llot -1 pasi oferta jonë ishte me çmim më të lirë për 250,712.70€ se sa oferta e OE fitues.

<u>**Neni 59**</u> par. 2 dhe 4 i LPP-së dlie neni 41.3 i RrUOPI' - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve -
Për arsve se vlerësimi dhe krahasimi kundrejt ankuesit nuk është bërë mbi parimin e trajtimit të barabartë me OE pjesëmarrës duke mos respektuar gjendjcn faktike dhe aplikimin e drejtë të dispozitave qenësore të procedurës së vlerësimit për vendosjen e drejtë dhe meritore të çështjes. Konsiderojmë se vlerësimi është udhëhequr në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e ligjshmërisë(legjislacionit të aplikueshëm material për prokurimin publik - LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim), parimin e efikasitetit/efektivitetit (parimit të ruajtjes së vlerës për para). Si rrjedhojë janë dëmtuar interesat materiale të ankuesit për tu shpërblver me kontratë nga një vendimarrje e padrejtë dhe e paligjshme e cila është e mbështetur mbi bazën e vërtetimit lë gabueshëm të gjendjcs faktike dhe aplikimit të ligjit jomaterial/joprocedural për një çështje (skadimin e regjistrimit të një kamioni) që kjo sipas kuptimit të kësaj

dispozite mund të konsiderohet devijim i vogël që mund të rregullohet nga OE pa e ndryshuar kushtin material kundrejt AK-së dhe aspektin e tenderit në fjalë, janë dëmtuar interesat materiale të ankucsit. E në anën tjetër për AK nuk ka paraqitur problem që rekomandojë për dhënie të kontratës një OE e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group".
Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së. Po të trajtoheshim në mëyrë të barabartë me OE konkurent- fituesin, në mënyrë të ligjshmë dhe të drejtë bazë të kritereve të kërkuara ligjore do të ekzistonin gjasat serioze që të shpalleshim fitues për Llot - 1 pasi oferta jonë ishte me çmim më të lirë.

Neni 4.4 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik. AK duke shkelur në nenin 4.4 të RRUOPP, që përbëjnë edhe parimet bazike të prokurimit publik <u>përzgjedhë ofertën e ofertuesit e cila është rreth 250,712.70€ më të shtrenjtë se oferta</u> epërgjegjshme dhe me çmim më të lirë e OE Ankues "El-Bau-Conex Group".
Për më tepër AK bjen në kundërshtim me vetveten duke mos marrë parasvsh kritere, kërkesa relevante që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura më objektin e lëndës në fjalë, parashtrohet pyetja logjike në ekstremin e kundërt qka i hvn në punë regjistrimi i mjeteve, kur ato kanë me u përdorur në një kohë të ardhmc që lidhen me mirëmbajtjen dimërore ? çka është relevante dhe e lidhur drejtëpërsësdrejti me Iëndën regjistrimi, ndërsa në anën tjetër kamioni ekziston, i cili do të përdoret në sezonin e dimrit ? kjo vërteton tezën se AK mundohet të gjej si shkas për eliminim arsye të paqëndrueshme, pambështetshme në aspektin juridik dhe faktik derisa propozon për dhënie të kontratës ofertën me çmimin më të iartë, në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 të LPP-së, në kundërshlitn me parimet bazë të prokurimit vlera për para, ekonomiciteti, efikasiteti, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë.

<u>Neni 60 - Kriteret për dhënien e kontratës -</u>
Për arsye se grupi i OE ankues përkundër iu është mohuar dhënia e kontratës si tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët karrshi OE të rekomanduar për kontratë(250,712.70€ më e lirë se oferta e fituesit) në bazë të gjendjes faktike dhe nga një rivlerësim i drejtë dhe i ligjshëm rezulton se ankuesi ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në përputhshmëri me kërkesat formale të nga aspekti administrativ dhe në përputshmëri me të gjitha kërkesat e kualifikimit (kriteret e përzgjedhjes) të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit si dhe tenderin që plotëson kriterin e dhënies së kontraës. Në anën tjetër konsiderojmë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuki ka përmbushur kërkesat e minimale të kualifikimit që hynë ek kërkesat e përzgjedhjes të cilat nga AK janë specifikuar në njoflimin për kontratë dhe dosjes së tedneri: në kuptim të nenit 56 paragrafi 1.1. të LPP-së, andaj i njejti nuk është dashur mos të kalojë fare në vlerësimin e kriterit për dhënien e kontratës sipas kritereve të vendosura në nenin 60 paragrafi 1.1. lë LPP-së, që është kusht i detyrueeshëm ligjor.

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Për aktivitetin në fjalë nga grupi i operatorëve ekonomik "Magjistralja&Alb Building" është ofruar çmimi dukshëm më i ulët në krahasim me dy operatorël tjerë ekonomik pjesëmarrës për pjesën - Regjionin e Gjilanit.

<u>Neni 64 pika iii) i LPl'-së- Dëshmitë e Kërkesave</u>
AK me rastin e vensosjes së kërkesës në pikën 5 të nenit 9.2 lidhur me nenin 9.1 të FTD-së lidhur me kërkesën për regjistrimin e mjeteve nuk ka vepruar në harmoni me nenin 64 pika iii) për faktin se kyçnen shumë qartë e shtjellon se një kandidat/tenderues duhet t'i plotësojë kriteret e kërkuara nga AK sipas nnet 69-71 të këtij ligji, ku shprehimisht thuhet: OE duhet t'i plotësojnë kriteret c kërkuara nga AK sipas nenit 6S - 71. Pra në kuptim të dispozilave të neneve 68-71 specifikisht nenit 69 të LPP-së regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që aplikohet

në bazë të LPP-së. Ligji i Prokurimit Publik në asnjë dispozitë nuk thotë se nëse i njejli nuk përmban dispozita të veçanta duhel të zbatohen përshtatshmërisht dispozita të ndonjë ligji tjetër.

Neni 69 par.4.5 - Aftësia teknike dhe/ose profesionale
Për arsye se kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", AK në arsvetimin e dhënë për eliminim sipas pikës a) sa i përket kërkesës në pikën 5 nenin9.1&9.2 të FTD-së ka nxjerrë vlerësim të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike duke mos zbatuar drejt dispozitën e nenit 69 par.4.5 lidhur me nenin 64 lë LPP-së për arsvet, faktet dhe provat e paraqitura si më lartë.

Neni 72 i LPP-së dhe neni 39 dhe 41.7 i RrUOPP- Dokumentacioni dhe informacioni shtcsë.

Për arsye se AK kundrejt grupit të grupit të OE ankues "El-Bau&Conex Group", fare nuk e ka zbatuar këtë dispozitë të së drejtës materiale që në raslin konkret ka pasur detyrim ta zbatojë për të kërkuar nga OE ankues informacione shtesë për të sqaruar këtë aspekt lë tenderit lidhur me çështjen që e ka përdorur për eliminim me arsvtimin e dhënë në pikën.
a) por edhe në pikën b) të Letrës Standarde edhe pse kjo çështje është tejet e qartë si në aspektin faktik e po ashtu edhe në kontekst ligjor ngase të gjitha dëshmitë dokumentare për ta plotësuar kërkesën nga neni 9.1&9.2 pika 5 janë pjesë e dosjes së tenderit siç edhe e vërtetuam më lartë nga përshkrimi që ë bëmë duke ju referuar dëshmive dokukemntare që janë pjesë e dosjes së tednerit.

Pretendimi Ankimor 5 lidhur me shkeljen e Neni 108/A paragrafi '12 - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve i LPP-së - Neni 8.2 i Rregullave për paraqitje të kërkesave për rishqvrtim pranë AK-së.

Me këtë vendim AK nuk ka eliminuar asnjërën nga shkeljet e cekura në pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në kërkesën për rishqvrtim. AK nuk ka shqyrtuar asnjërin nga pretendimet ankimore dhe nuk ka analizuar, shqvrtuar dhe administruar faktet dhe provat materiale të cilat janë pasqyruar në ankesë. Asnjërën prej tyre nuk e ka vlerësuar në pajtim me dispozitën qencsore të vlerësimit, nenin 59.4 të LPP-së lidhur me nenin 1, nenin 6, nenin 7, nenin 69 par.4.5 dhe nenin 72 të LPP-së e që për pasojë ka ngelur pranë rezultatit të njejtë i cili nuk është i bazuar dhe nxjerr mbi vlerësime të drejta dhe të ligjshme. Kv vendim është në kundërshtim edhe me Ligjin e Përgjithshëm të Procedurës Administrative të nenit 48 (arsyetimi i një akti administrativ) pasi që nuk përmban elementet e arsyetimit që duhet ti ketë një akt administrativ në rastin konkret vendim siç kërkohet edhe me Iegjislacionin e LPP-së, ngase në vendim nuk është dhënë asnjë arsyetim që: shpjegon situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, shkaqet për të cilat nuk janë pranuar pretendimet ankimore, shpjegimin e bazës ligjore dhe faklike të aktit. Nga përmbajtja e vendimit vërehet se AK nuk i ka vlerësuar asnjërin nga pretendimet ankimore. Për të gjitha pretendimet ankimore është përgjigjur duke përshkruar asryelimin e njejtë sikurse në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar - OE ankues.

---------- perfundim i pretendimeve ankimore ----------

Kështu që me të gjitha këto veprime në raport me OE në fjalë lë bazuara në faktet dhe provat e lartëcekura konsiderojmë se AK ka shkelur dispozitat qenësore dhe procedurale legjislacionit të prokurimit në fuqi duke filluar nga: neni 1, neni 6, neni 7 par.1,2,4, neni 56 par.1.1 dhe 1.2, neni 59. 4, neni 60 par.1.1, nenin 69 të LPP-së nenin nenit 4.4, nenit 39, nenit 41.3 dhe 41.7 për Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. Andaj kërkohet që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura, Organi Shqyrtues i Prokuriinit të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET** si e bazuar ANKESA e Grupi i OE "EL-BAU" sh.p.k. & CONEX GROUP" sh.p.k.;

II. **ANULOHET** Vendimi i AK-së i Nr.prot. 5482 i dt. 22.05.2019 me të cilin është Refuzuar si e pabazë Kërkesa për Rishqvrlim e parashtruar në emër të grupit të konzorciumit nga OE ankues "El-Bau Sh.p.k" si dhe në anën tjetër është vërtetuar dhc Iënë në fuqi vendimi i atakuar për dhënien e kontratës OE„Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban" për Lot 2 , i dt. 14.05.2019;

III. **ANULOHET** Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës OE „Damastion Project Sh.p.k.&Via Egnatia Sh.p.k.& Urban" për Lot 2 , i dt. 14.05.2019;

IV. **ANULOHET** Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, grupin e OE"El-Bau Sh.p.k.&Conex Group Sh.p.k.", i dt. 14.05.2019, me propozim që kjo lëndë të kthehet në RI-VLERËSIM duke marrë masa korrigjuese nga AK për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj niënyrën se si shkeljn e supozunr kn shkaktunr ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëine niaterialc, ne rnst se përfshini pretendinie për konipensiiii.

Grupi i Operatorëve Ekonomik "EL-BAU" sh.p.k. & CONEX GROUP sh.p.k. në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore lë lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....18.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....Punë, vlerë emadhe

Vlera e parashikuar e kontratës ..... totali 9.975.000,00€
(Lot 1: 5,175,000.00 euro) dhe (Lot 2: 4,800,000.00 euro)

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 15.04.2019

Data e hapjes së ofertave..... 15.04.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave..... 13.05.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues 14.05.2019
(OE ankues 1 - i eliminuar, OE ankues 2 - i pasuksesshëm)

Data e Vendimit të AK për dhënie..... 14.05.2019

Data e Kërkesës për rishqyrtim..... 17.05.2019 dhe 20.05.2019

Data e Vendimit të AK-së lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.....20.05.2019 dhe 22.05.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092
Kërkesa 2.Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës
Kërkesa 3.Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës
Kërkesa 4. Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Evidenca 1.Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – .
Evidenca 2.Vërtetim nga Administrata Tatimore
Evidenca 3.Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje
Evidenca 4 .Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)
Kërkesa 2. Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)
Kërkesa 3. Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Evidenca 1 Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit
Evidenca 2 Kopja e certifikatës së TVSH-së
Evidenca 3 Kopja e certifikatës së numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kërkesa 1. OE duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te fundit ka qene ne vlere prej jo me pak se pjesën I 4, 000,000 eruo dhe pjesën II 3,000,000.00 euro
Kërkesa 2.Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 € per pjesën I dhe prej së paku 250,000.00 € per pjesën II ose qasje në kredi nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia.

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Dëshmia – 1 Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit
Deshmia - 2 Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi , dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucion
Vëmendje! Shembull nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 4,000.000.00 euro dhe për Lot 2 2 është 3,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE i cili aplikon per dy pjesët (lot) është 7,000,000.00 euro Nese OE aplikon per te dy pjesët atëherë mbeshtjetja financiare duhet te

jete 550,000.00 euro

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1. Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).
Kërkesa 2.Udhëheqës i punishtes Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, infrastrukturë rrugore me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve; minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.
Kërkesa 3 Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune pas diplomimit në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).
Kërkesa 4 Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 3,500,000.00 euro per pjesën I dhe 3,000,000.00 euro per pjesën II . Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve
Kërkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 per pjesën I dhe pjesën 2.
Kërkesa 6. OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se asfaltit. 7. OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr 8. OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se betonit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deshmija 1 Dëshmia 1 CV e inxhinierit, diploma e noterizuar,, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet te ofroj nje deklarat qe nuk eshte i angazhuar ne porjket te MIT (deklarat e nënshkruar).
Dëshmia 2 CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit
Dëshmia 3 CV, kontrata e punës me punedhenesin (kopje e noterizuar), diploma (e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit Vëmendje! Shembull nëse OE aplikon për pjesën 1 dhe pjesën 2, ne stafin e vete duhet te prezantoj 2 projekt menaxher, 2 udheheqesa te punishtes, 2 inxhiniera te komunikacionit.
Deshmia 4. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare
Vëmendje! Shembull nëse shuma totale e kontratave për punë e kërkuar për Lot 1 është 3,500,000.00 dhe për Lot 2 është 3,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE i cili aplikon per dy pjeste (lot) është 7,500,000.00 euro.
Deshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).
Vëmendje: Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon per dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje per dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1.
Dëshmia 6, 7, 8 - Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.
Vëmendje: Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.(sipas nr. rendor të procesverbalit të hapjes)	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi për Lot 1 të ofertuar (€)		Çmimi për Lot 2 të ofertuar (€)
1	" Arbotec " SH.P.K., Bulevardi Bill Klinton nr.76, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	1	**4,568,438,10**	
2	" Arbotec " SH.P.K., Bulevardi Bill Klinton nr.76, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	2		**4,315,628,25**
3	"FAMIS CO-HC" SH.A, SUHAREKE-PRIZREN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKE	SUHAREKE	1	**4,276,744,89**	
4	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T. A.B.C. ; KOSOVA ASFALT SH.P.K., 20 Qershori, 11000, PODUJEVË	PODUJEVË	2		**3,877,218,00**
5	GRANIT Shpk, Zona Industriale, 31000, Istog	Istog	1	**4,655,550,00**	
6	Lika Trade" Sh.p.k., Isniq-Deçan, 51000, Deçan	Deçan	1	**3,844,444,80**	
7	Grup i Operatorëve Ekonomik DAMASTION PROJECT SH.P.K; VIA EGNATIA SH.P.K.; N.N.SH. Urban, ISA KASTRATI, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	1	**3,250,795,50**	
8	Grup i Operatorëve Ekonomik DAMASTION PROJECT SH.P.K; VIA EGNATIA SH.P.K.; N.N.SH. Urban, ISA KASTRATI, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	2		**3,500,654,70**
9	Grup i Operatorëve Ekonomik EL-BAU SH.P.K.; Conex Group SH.P.K., LIMON STANECI P.N., -, GJILAN	GJILAN	2		**3,249,942,00**
10	Companya Eskavatori Sh.p.k., Magjis. Ferizaj - Prishtinë, -, FERIZAJ	FERIZAJ	1	**2,930,752,5**	
11	Companya Eskavatori Sh.p.k., Magjis. Ferizaj - Prishtinë, -, FERIZAJ	FERIZAJ	2		**3,062,623,80**
12	Grup i Operatorëve Ekonomik: " INTEGRAL " Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K., Ahmet Krasniqi, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	1	**3,389,010,00**	
13	Grup i Operatorëve Ekonomik: " INTEGRAL " Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K., Ahmet Krasniqi, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	2		**3,370,010,40**
14	Grup i Operatorëve Ekonomik JAHA COMPANY sh.p.k.; Toifor Sh.p.k., Rr. Ismail Qemali Nr.17 Lagja Arbëria, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	1	**4,954,437,00**	

15	Grup i Operatorëve Ekonomik JAHA COMPANY sh.p.k.; Toifor Sh.p.k., Rr. Ismail Qemali Nr.17 Lagja Arbëria, 10000, PRISHTINË	PRISHTINË	2		**4,278,001,80**
16	KAG - Asphalt Company Sh.p.k., Krushe e Vogël - Prizren, 20000, Kosovë	Krushe e Vogël - Prizren	1	**3,888,000.00**	
17	"SALLAHU" SH.P.K., Rr.Baki Dullovi Nr.158, 71000, Kaçanik	Kaçanik	1	**5,093,160.00**	
18	"SALLAHU" SH.P.K., Rr.Baki Dullovi Nr.158, 71000, Kaçanik	Kaçanik	2		**4,643,874,60**
19	Grup i Operatorëve Ekonomik: " VIA " SH.P.K.; N.T.P. "EUROKOS" SH.P.K., RR - TAHIR SINANI, -, LIPJAN	LIPJAN	1	**3,383,684.10**	
20	Grup i Operatorëve Ekonomik: " VIA " SH.P.K.; N.T.P. "EUROKOS" SH.P.K., RR - TAHIR SINANI, -, LIPJAN	LIPJAN	2		**3,288,888,89**
21	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.,,Victoria Invest International" Sh.p.k.; Victoria Invest shpk, Brigada 123, 23000, SUHAREKË	SUHAREKË	1	**4,426,663.80**	
22	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.,,Victoria Invest International" Sh.p.k.; Victoria Invest shpk, Brigada 123, 23000, SUHAREKË	SUHAREKË	2		**4,142,460,60**
23	N.N.T.SH. DRINI COMPANY SH.P.K., Ersan Mazreku Lam 2/1, 20000, PRIZREN	PRIZREN	1	**3,956,956,56**	
24	Grup i Operatorëve Ekonomik: " 2A Group " SH.P.K.; " 2T " SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, Hyzri Talla,Qendra Tregtare Bregu i Diellit, -, PRISHTINË	PRISHTINË	2		**4,477,323,00**

Komisioni vlerësues pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:
Jetmir Alaj – kryetar
Emir Morina – anëtar
Hysejn Dobërcani – anëtar

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Në bazë të kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dokumentacionin tenderues, komisioni për vlerësimin e ofertave i emëruar me vendim nga MI.
Komisioni pas procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstatoi se nga 24 operator ekonomikë të cilët kanë ofertuar për projektin: **"Mirëmbajtjen rutinore dhe dimërore të autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6, nga udhëkryqi A7 A6 deri ne kyqjen ne Konjuh si dhe rrugën Nacionale N9"-**

per Lot 1, Komisioni i vlersimit ka konstatuar se 2 OE prej tyre ishin të përgjegjshëm, ndersa 13 operator ekonomik nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuar të përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, kriter për dhënie te kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me çmim më te ulet".

për Lot 2, Komisioni i vlersimit ka konstatuar 3 OE prej tyre ishin të përgjegjshëm ndersa 11 operator ekonomik nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuar të përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, kriter për dhënie te kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me çmim më te ulet".

Në baze te LPP Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L 237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Komisioni për vlerësimin e ofertave ne mënyrë unanime rekomandon për kontratë:

Për Lot 2 rekomandon për kontratë operatorin ekonomik **Damastion Projekt Sh.P.K& Via Egnatia Sh.P.K&Urban** i cili për Lot 2 ka ofruar çmimin më të ulët në mesin e operatorëve të pëgjegjshëm.

1. **"FAMIS CO-HC" SH.A 600039706**– OE ka aplikuar per pjesën 1 një .OE i plotëson te gjitha kërkesat ne njoftim per kontrat dhe ne dosjen e tenderit .Dhe rekomandohet per kontrat per pjesën e parë (1)

2. **Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T. A.B.C. ; KOSOVA ASFALT SH.P.K**- OE ka aplikuar per pjesën dy .OE i plotëson te gjitha kërkesat ne njoftim per kontrat dhe ne dosjen e tenderit .
3. **GRANIT Shp 810292847**– OE ka apliku per pjesë një.OE nuk i plotëson kërkesat në ne dosjen e tenderit tek aneksi 1);është kërkuar lista e mjeteve ,stabilimenteve dhe paisjeve teknike që jan te domozdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosjen e tenderit tek aneksi 1 për pjesën 1 dhe per pjesën 2 e cila duhet te dëshmohet me paisjet te cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jen me afat te regjistrimit),ndërsa paisjet tjera , OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e paisjeve (faturë, DUD etj), ndërsa OE për Borheqesit (Pllugjet) dhe shpërndarësit automatik të kripës ka ofruar fotografi.

4. **Lika Trade" Sh.p.k. 600026555-** OE ka aplikuar për pjesë një. OE nuk i plotëson kërkesat ne dosjen e tenderit.

a) Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderitn,është kërkuar Lista e mjeteve,stabilimenteve dhe paisjeve teknike që janë të domozdosheme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek aneksi 1 për pjesën 1 dhe per pjesën 2 e cila duhet te dëshmohet me paisje te cilat regjistrohen duhet te dëshmohen me librezën e regjistrimit (paisjet duhet te jen me afat të regjistrimit)ndërsa paisjet tjera OE duhet ti dëshmoj me fatur, DUD etj,Traktor 55 KF ,ndërsa OE e ka ofru Traktorin me 33 KF

b) Eshtë kerku stafi Profesional 1.Menagjer i Projektit,Inxhinjer i dip.i ndërtimtarisë,drejtimi konstruktiv ose infrastruktur rrugore me se paku 3 vjet pervoj pune pas diplomimit,të ketë dëshmi se ka menagjuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi,ose ndërtimi i rrugve) dhe Udhëheqes i punishtes Inxhinjer i dip.i ndërtimtarisë,drejtimi konstruktiv ,infrastruktur rrugore më së paku 2 vite pervoj pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit ,rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugve me se paku dy 2 vite pervoj pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit ,rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve : minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar,Ndersa kompania ka ofru referenca te lëshuara nga vet kompania aplikues LIKA e cila per referencat e atyre viteve nuk ka paguar tatimin e stafit .Duke marr parasysh at qe u cek me larët i bie qe stafi nuk ka menagjuar ato projekte.

5. **Grup i Operatorëve Ekonomik EL-BAU SH.P.K.; Conex Group SH.P.K.–**
OE ka apliku për pjesë dy.OE nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne njoftim per kontrat dhe ne dosjen e tenderit.
a)Në dosjen e tenderit tek specifikat teknike janë kërkuar dhjet (10)shpërndarës automatik të kripës ,ndërsa OE ka ofru dëshmi/dokument mbi pronësin për 6 shpërndarësit automatik të kripës.
b) Janë kërku 10 automjete transportuse (kamion)në të cilin montohen Borheqësit (Pllugjet)dhe shpërndarësit automatik të kripës te cilatë duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (paisjet duhet te jen me afat të regjistrimit),ndërsa kompania e ka ofruar një kamion me nr.06-397 DL pa afat te regjistrimit.

